



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:027229

Datë: 13.03.2023

Numri i dokumentit: 04072270

PS.nr.57/2022

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prishtinë- Departamenti Special – kryetari trupit gjykues gjyqtari: Lutfi Shala me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi-Metaj duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve për shkak të veprës penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, dhe Dhënia e ndihmës kryerësve, pas kryerjes se veprës penale nga neni 380 par.2 pika 2.8 lidhur me par.1 të KPRK-së, **S.B, B.R dhe N.M** për shkak të veprës penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **V.P** për shkak të veprës penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së **J.A** për shkak të veprës penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPRK- së, të akuzuar nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës- Departamenti për Krim të Organizuar nr. PPS.nr.32/2022 të datë 27.12.2022, në shqyrtimin fillestar publik të datës ..., ku prezentë ishin prokurorja Habibe Salihu, i akuzuari Xh.Sh dhe mbrojtësi i tij av. A.S i akuzuari B.R dhe mbrojtësi i tij av. A. H., i akuzuari N.M dhe mbrojtësja e tij av.L. K., i akuzuari S.B dhe mbrojtësja e tij av.K.K., i akuzuari J.A dhe mbrojtësja e tij av.T.Zh., i akuzuari V. P. dhe mbrojtësja e tij av.H.H.gjykata me datë .. mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

Xh.Sh, nga i ati S.dhe nënës B., e gjinisë Q., i lindur më .. në P., tani me banim në fshatin B., Komuna e D., me numër personal .., ka të kryer shkollën fillore, me profesion shofer në kompaninë “A.” me seli në fshatin B., i martuar, babai i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

B.R, nga i ati Q., dhe nënës A., e gjinisë L. , i lindur më .. në Sh., tani me vendbanim në Sh.i i R, pa nr. në Sh., të Republikës së Sh., me numër të pasaportës .., ka të kryer shkollën fillore, më profesion bojaxhi, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Shqipërisë.

N.M nga i ati U. dhe nënës H., e gjinisë B.i, i lindur më .. në fshatin M. Komuna e S., tani me vendbanim në M., në rrugën “S. G.”, me numër personal të letërnjoftimit .., ka të kryer shkollën e mesme, punon me makina të letrës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

S.B nga i ati I.dhe nënës M., e gjinisë S., i lindur më .. në Sh., tani me vendbanim në lagjen P. – Bahqja e S.pa nr., të Republikës së Sh., me numër të pasaportës .., ka të kryer shkollën fillore, punëtor fizik, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Shqipërisë.

J.A, nga i ati Z., dhe nënës N., e gjinisë Z. i lindur më .., në fsh. M.t i U.K. e O., me vendbanim në fshatin M. i U., Komuna O., me nr. personal ..., ka të kryer shkollën fillore, tani i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

V.P nga i ati N.dhe nënës Z., e gjinisë D. i lindur me .., në fshatin Zh, me vendbanim në fshatin Zh., Komuna V., me numër personal ..., te lëshuar nga MPB e R. Së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i ve, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari Xh.Sh

I.

Sepse: me datë .. rreth orës 21:50 në fshatin B. Komuna e D., në shtëpinë e tij ka poseduar substancë narkotike si dhe një peshore elektronike që shërben për matjen e narkotikëve, po ashtu 85 qese të najlonit, të zbrazura dhe një foli plastike, që pas ekzaminimit të substancës narkotike ka rezultuar të jetë substancë e llojit marihuanë në peshë prej 399, 24 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.

II.

Me atë datë .. deri me datën .. i akuzuari Xh.Sh me dashje e ndihmon në shmangien e zbulimit dhe arrestimit të pandehurit M. Q., në atë mënyrë që të njëjtit i dërgon mjete financiare me qëllim që të njëjtit të fshihet, e ndihmon për të siguruar transport në rrugë ilegale prej S.për në K., ashtu që me datë .. është ndaluar nga Policia e Kosovës, duke transportuar të pandehurin M. Q.me automjetin e tij të markës Mercedes me targa

- Me këtë ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par. 2 pika 2,8 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Të akuzuarit B.R S. B. dhe N.M

Sepse: gjatë viti 2022 të akuzuarit në vazhdimësi duke bashkëvepruar njëri me tjetrin pa autorizim kanë shpërndare dhe transportuar substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge me qëllim të shitje, shpërndarjes dhe ofrimit për dhitje, në atë mënyrë që i akuzuari Gj.R i ka dërguar me qëllim të shitjes substancën narkotike të akuzuarit G.A përmes të akuzuarit B.R dhe S.B më pastaj i akuzuari B.R, nga Sh.për në K., me automjetin e tipit Mercedes, me targa të regjistrimit të Republikës së Sh., me datë .. rreth orës 06:30, ka kaluar pikën kufitare në V., pastaj ka vazhduar deri në fshatin V. komuna e M. ku tek Marketi ‘‘Q’’, është takuar me të akuzuarin N.M dhe se bashku kanë hyrë në garazhin e shtëpisë së N. për t’ia dorëzuar substancën narkotike të cilën e kishte fshehur në bunkerin special të këtij automjeti, substancën në peshë totale prej 10.583 kg, të ndarë në dy thasë të najlonit, në 15 paketime në pesha të ndryshme, po ashtu në shtëpinë a e të akuzuarit konkretisht në garazhin

e shtëpisë se të akuzuarit N.M janë gjetur sasi prej 18 kg, 905 gr narkotikë, me ç'rast nga policia janë sekuestruar. I akuzuari S.B në të njëjtën datë, pa autorizim ka shpërndarë dhe transportuar substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge me qëllim të shitjes, shpërndarjes dhe ofrimit për shitje ashtu që ka transportuar substancë narkotike nga Sh. për në K. në atë mënyrë që me automjetin e tipit Mercedes me targa të Republikës së Sh. ... nga Shqipëria për në K. rreth orës 5:40 ka kaluar pikën kufitare të V. me qëllim që të arrij në destinacionin ku kishte për ta dërguar sasinë me narkotik, por me të arritur në F. K., ndalet nga Policia e Kosovës e që gjatë kontrollimit të automjetit në bunkerin e modifikuar të veturës, policia gjen 10.072 kg, substancë narkotike të llojit marihuanë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari Venhar Pajaziti

Me datë 16.09.2022, të akuzuarit V.P. dhe F. A., kanë shkuar në shtëpinë e të akuzuarit G.A. i cili ka poseduar me qëllim të shitjes substanca narkotike, në atë mënyrë që të akuzuarit V.dhe F., kanë blerë narkotikë të llojit marihuanë në sasi të përgjithshme prej 205 g, të ndara në dy pjesë, 102 g, dhe 103 g, që fillimisht i akuzuari G. jua ka ofruar në shikim një sasi të vogël si mostër dhe pas pajtimit ju ka shitur sasinë e përgjithshme prej 205 g, në shumë prej 400 euro.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari J.A

Me datë ... në fshatin M. komuna e O.me qëllim të shitë blerjes, ka poseduar narkotikë të llojit marihuanë, ashtu që gjatë bastisjes nga zyrtarët policor tek i njëjti janë gjetur dhe sekuestruar, në dhomën e gjumit në katin e dytë 151 gram substancë e llojit marihuanë, tre gram kokainë, një peshore elektronike, katër llulla, tre mullinjë për bluarje të marihuanës, disa qese najloni, një shufër metalike para të gatshme 840 euro, ndërsa në një shtëpi ndihmëse (shupë) janë gjetur edhe 17.0 gram substancë e dyshuar narkotikë e llojit marihuanë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42,43, 69, 76, 79, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarit **Xh.Sh**, për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i'a:

Përcakton

Të akuzuarin **Xh.Sh** për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë) euro.

Për veprën penale në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muajsh.

Në bazë të nenit 43 par. 5 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh i zëvendësohet me dënimin me gjobë në **lartësi prej 2,000 (dymijë)** euro.

Konform nenit 76 gjykata të akuzuarin Xh.Sh e gjykon me dënim unik me gjobë në lartësi prej **4,000 (katërmijë)** euro.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **11.03.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42,43, 69, 79, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarve **B.R, S.B.,N.M,V.P. dhe J.A**, për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i'u shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË

Të akuzuarin **B.R** për veprën penale si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë)** euro.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin **S.B** për veprën penale si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë)** euro.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin **N.M** për veprën penale si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 19 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë)** euro.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **20.04.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin **V. P.** për veprën penale si në pikën **IV** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 muaj si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë)** euro.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **16.09.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarin **J.A** për veprën penale si në pikën **V** të dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykon me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 5,000 (pesëmijë) euro.**

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data **16.09.2022 e deri me datën 23.01.2023**, i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, **duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.**

Konform nenit 59 par. 2 nën par. 2,8 lidhur me nenin 67 të KPRK-së, së bashku me dënimin kryesor ndaj të akuzuarve **S.B dhe B.R** gjykata shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

I.Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje **prej 5 viteve**, dhe kjo kohë llogaritet pasi që të njëjtit ta kenë vuajtur dënimin e shqiptuar.

Të akuzuarit **Xh.Sh**,konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 399,24 gram, 85 qese të najlonit si dhe një peshore elektrike për matjen e narkotikëve si dhe një foli plastike, **konfiskohen.**

Të akuzuarit **B.R**, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substanca narkotike në peshë totale 10.583 kg, vetura e tipit M.. me targa ..., para në shumë prej 355 euro si dhe dy (2) telefona samsung me kartela **konfiskohen.**

Të akuzuarit **N.M** konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej 18 kg 905 gram, vetura e tipit M. me targa .., paratë në shumë prej 9.800 euro dhe 6580 dinar të S. si dhe dy (2) telefona I. me dy kartela **konfiskohen.**

Të akuzuarit **S.B** konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej 10.072 kg, vetura e tipit M.me targa ..., paratë në shumë prej 352 euro, dhe një (1) telefona I. me kartelë vodafon **konfiskohen.**

Të akuzuarit **V.P** konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së supstancat narkotike në sasi prej 205 gram, një telefon I. X max dhe para në shumë 40 euro, **konfiskohen.**

Të akuzuarit **J.A**, konform 282 të KPPRK-së, dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së substancat narkotike në sasi prej 151 gram marihuanë, 3 gram kokain, dhe 17.0 gram marihuanë, një peshore elektrike, katër llulla, tre mullinjë për bluarje të marihuanës, qese najloni një shufër metalike dhe para të gatëshme në vler prej 840 euro **konfiskohen.**

OBLIGOHEN të akuzuarit që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensoi shumën prej **200 euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **100 euro**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej **100 euro** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PPS.nr.32/2022 të datës 27.12.2022, **M.Q dhe F.M** për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK, lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.3 dhe 1.9 të KPRK, **M.Q edhe për veprën penale** Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, **Xh.Sh** Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, dhe Dhënia e ndihmës kryerësve, pas kryerjes se veprës penale nga neni 380 par.2, pika 2.8 lidhur me par.1 të KPRK, **G.A, Gj.R S.B, B.R dhe N.M** Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, **G.A** Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, **V.P dhe F.A.** Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, lidhur me nenin 31 të KPRK, **J.A** Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës se bashku me aktakuzën, ka sjellë marrëveshjet për pranim të fajësisë për te pandehurit **Xh.Sh** për veprat penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, dhe Dhënia e ndihmës kryerësve, pas kryerjes se veprës penale nga neni 380 par.2, pika 2.8 lidhur me par.1 të KPRK, të pandehurit **B.R, S.B dhe N.M** për veprën penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, **dhe V.P** për veprën penale Blerja posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata caktoi dhe mbajti seancën fillestare, edhe në këtë seancë, të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në këtë çështje penale dhe i'u ka lexuar aktakuza, ku të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar akuzën dhe nuk ka nevojë për ndonjë sqarim.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokuroria Speciale, gjykata ka ftuar të akuzuarit të cilët nuk kanë hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë që të deklarohen lidhur me pranimin e fajësisë.

Para se të akuzuarit të deklarohen rreth pranimin të fajësisë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuarve, lidhur me pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë sanksionin penal për veprën penale që parashihet, se nuk do të mund t'i kundërshtojë provat apo të parashtrijë prova në këtë çështje penale, se nuk do mund ta atakojnë vendimin e gjykatës lidhur me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por se mund ta atakojë për shkak të lartësisë mbi dënimin dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë gjykata detyrimisht duhet ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Të akuzuarit **M. Q., F.M, Gj. R., F.A** deklarohen të pafajshëm për veprat penale ashtu siç i ngarkon aktakuza e prokurorisë speciale, i akuzuari **G.A** deklarohet i fajshëm për veprën penale si në pikën 6 të dispozitivit të aktakuzës, ndërsa nuk e pranon fajësinë për pikën 5 të dispozitivit të aktakuzës, ndërsa i akuzuari **J.A** e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.A, av. T. Zh. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit tim është bërë në konsultim paraprak me mbrojtësen duke i pas parasysh benefitet dhe pasojat mbi pranimin e fajësisë meqenëse i njëjti e pranoi fajësinë në këtë seancë fillestare i propozojmë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtari i çështjes të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese posaçërisht pranimin e fajësisë në këtë fazë të hershme por ta ketë parasysh se edhe prokurorisë me propozim i jemi drejtuar rreth hyrjes në marrëveshje për pranimin e fajësisë mirëpo me të njëjtën nuk jemi dakorduar rreth dënimit, po ashtu gjykata të ketë parasysh se i njëjti është përdorues i substancave narkotike dhe gjendjen e dobët ekonomike të tij dhe premtimin se në të ardhshmen i njëjti nuk do të përsëris vepra të natyrës së njëjtë

apo çfarëdo natyre tjetër që bie ndesh me ligjin dhe po ashtu të ketë parasysh gjendjen e dobët ekonomike të të njëjtit.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.A, av.R. K lidhur me pranimin e fajësisë për pikën 6 të dispozitivit të aktakuzës nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se i mbrojturi im në konsultim të mjaftueshëm me mua bashkërisht kemi vendosur që ta pranojmë veprën penale nën pikën 6 të aktakuzës. Më lejoni të theksoj se po të kishim njoftuar me kohë për këtë aktakuzë do të ekzistonte një marrëveshje për pranimin e fajësisë për pikën 6 të aktakuzës mirëpo të mbrojturit tim i është caktuar paraburgimit madje i është vazhdua paraburgimi për një veprë tjetër penale për të cilën është akuzuar vëllai i tij i cili sot e pranoj fajësinë. I mbrojturi im është kthyer nga Ç, pikërisht kur është njoftuar se është duke u kërkuar nga Prokuroria kthimi është bërë pas 2 muajve kur është arrestuar vëllai i tij. Këto i përmenda për tu njoftuar se ne për herë të parë jemi ballafaquar m provat e PSRK-së, kur e kemi pranuar fajësinë për pikën 6 të aktakuzës. Pranimi është vullnetar dhe i propozojmë gjykatës të akceptoj këtë pranim.

Prokurori i Prokurorisë Speciale Habibe Salihu lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit J.A, si dhe pranimin e fajësisë për pikën 6 të aktakuzës për të akuzuarin G.A deklaroi se: sa i përket pranimin të fajësisë për të akuzuarin J.A pajtohem në tërësi me pranimin e fajësisë e cila është bërë në përputhje të plotë me provat e gjendura në shkresat e lëndës. Vlerësoj faktin dhe i propozoj gjykatës të ketë parasysh që i akuzuari J.A edhe gjatë fazës kur është dëgjua në prokurori ka qenë i gatshëm të pranoj fajësinë për këtë vet ka paraqitur kërkesë për fillimin e negociatave për marrëveshje, fillimisht i ka pas disa hendikepe për shkak se avokaten nuk e ka pas në Kosovë, por edhe sot si prokurorë e çështjes pajtohem që J. A. ti shfrytëzon benefitet që kishte me i shfrytëzua sikur të kishte lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë. Po ashtu, pajtohem që edhe G.A ti pranohet pranimi i fajësisë për pikën 6 të aktakuzës shkak se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të të akuzuarit J.A se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, si dhe pas deklarimit të të akuzuarit G.A se ndjehet fajtor për veprën penale si në pikën 6 të dispozitivit të aktakuzës gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit pasi që është bindur plotësisht se të njëjti janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Gjykata vlerëson se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë behet vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, materialet e prezantuara nga Prokurori Special e që janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale cilat i vihet në barrë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimet e pranimin të fajësisë nga të akuzuarit dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që kanë kryer të akuzuarit, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimin të fajësisë nga të akuzuarit i ka pranuar si të tilla.

Për të akuzuarit M. Q., F.M., Gj. R., F. A, dhe G.A gjykata me **AKTVENDIM** ka veçuar procedurën penale, ku të njëjtit do të gjykohen ndaras, si dhe ndaj të akuzuarit G.A i cili ka pranuar fajësinë për veprën penale si nën pikën 6 të aktakuzës të cilën fajësi gjykata e ka aprovuar është shtyrë shpallja e aktgjykimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata pas deklarimit të të akuzuarve të cilët nuk kanë hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë ka vazhduar me seancën për shqyrtimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë, në të cilin seancë komfor nenit 246 par.3 të KPPK-të, Prokurorja Speciale Habibe Salihu ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, se me të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre janë pajtuar për të gjitha pikat e aktakuzës, për dënimin e rekomanduar, se të akuzuarit me vullnet të plotë, me vetëdije të plotë

dhe pa kurrfarë trysnie e kanë pranuar fajësinë e duke qenë të vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet që sjell pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe kërkoi nga gjykata që pasi ti çmojë marrëveshjet dhe të njëjtat ti shqyrtojë të njëjtat të pranohen.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.Sh av. A. S. me autorizim zëvendëses, deklaroi se pajtohet në tërësi me deklarin e prokurorit special dhe se i mbrojturi i tij me vullnet të plotë dhe pa presion ka hyrë në negociatë për marrëveshjen për pranim dhe i propozoj gjykatës që këtë marrëveshje ta pranoj në tërësi.

I akuzuari Xh.Sh deklaroi se në tërësi e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij duke theksuar se në tërësi qëndron pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë mes tij dhe prokurorit të shtetit, andaj kërkon që të pranohet kjo marrëveshje nga gjykata.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.R av. A. H., deklaroi se mbesim në tërësi pranë marrëveshjes së lidhur dhe se e njëjta është lidhur dhe hartuar në pajtim me dispozitën e nenit 233 të KPPRK-së andaj edhe sot kërkohet nga ju që të njëjtën ta aprovoj.

I akuzuari B.R deklaroi se në tërësi e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij duke theksuar se në tërësi qëndron pranë marrëveshjes për pranimin, andaj kërkon që të pranohet kjo marrëveshje nga gjykata.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B av. K.K., deklaroi se po ashtu mbështet dhe mbetem pranë marrëveshjen me shkrim të lidhur me PSRK-n lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin tim, pa dashur që të tingëllojë se dua të dalë jashtë asaj marrëveshje por duke pasur parasysh se KPPRK-ja e len në diskrecion të KTGJ-së lartësinë e dënimit përkundër asaj që është paraparë në marrëveshje unë do të parashtroj më tepër një lutje se sa propozim që për shkaqe humanitare dhe për shkak se lartësia e dënimit me gjobë është shumë e lartë që së paku gjykata për hir të atij humanizmit të merr në konsideratë dhe qoftë edhe një ditë figurativisht të themi të bëj ulje të dënimit për të mbrojturin tim. Gjykatës do ti ishëm falënderues dhe mirënjohës duke pas parasysh edhe se i mbrojturi im është shtetas i huaj edhe që e ka të vështirë si shtetas i huaj ti shfrytëzoj benefitet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe fakti që është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe ka shprehur një keqardhje, pendesë dhe premtim të singertë si për shtetin tonë, ashtu edhe për të vetin dhe veten e tij.

I akuzuari S.B, deklaroi se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij dhe e ka të qartë marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M av. L.K., deklaroi se mbesim në tërësi pranë marrëveshjes dhe i propozojmë kësaj gjykate që të njëjtën ta aprovoj. Po ashtu, dua të shtoj se e mbështet fjalën e parafolësës koleges lidhur me mundësinë e uljes së dënimit, qoftë me burg efektiv, qoftë me gjobë.

I akuzuari N.M deklaroi se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij dhe e ka të qartë marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. P. av. H. H., qëndrojmë pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë të lidhur në PSRK me dt.... dhe kërkohet nga gjykata ta aprovoj këtë marrëveshje.

I akuzuari V.P deklaroi se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij dhe e ka të qartë marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimit apo mospranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurorit special, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, e komfor nenit 233 par. 18 të KPPRK-së, përcaktoi se i akuzuari: në tërësi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraqitura në nenin 253 par. 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurorit special, mbrojtësit dhe të akuzuarit dhe pasi që është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin e 18 të nenit 233 të KPPRK-së, komfor nenit 233 par. 21 lidhur me 247 par. 1 të KPPRK-së, me **AKTVENDIM** pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorit Special në njëërën anë si dhe të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës së kësaj gjykate, e që palët në procedurë janë pajtuar me pranimin e marrëveshjes se pranuar nga gjykata pa asnjë vërejtje.

Nga Marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e prokurorit special, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, për të cilën akuzohen.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **J.A** ka gjetur; **pranimin e fajësisë**, pasi që i akuzuari që në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, dhe po ashtu ka shprehur gatishmëri që të hyj në marrëveshje për pranimin e fajësisë, e pranon se ka kryer veprën penale, është penduar, dhe premtun se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale; **rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar**, të njëjtin shkaktimi i kësaj veprë në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht edhe vet atë; **keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar, moshën e personit të dënuar** i njëjti është i moshës së re, **bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën** pasi që i njëjti ka pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe me organet të tjera të drejtësisë, faktin se i njëjti nuk kemi të dhëna se ka qenë i dënuar më parë.

Gjykata gjithashtu duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit, ka gjetur; **shkallën e lartë të pjesëmarrjes**; pasi që i akuzuari me vetëdije të plotë ka dashtë që të kryhet kjo veprë penale; **shkallën e dëmit të shkaktuar**, faktin se këto vepra penale janë shumë të shprehura në Kosovë, faktin se këto vepra penale kanë ndikim negativ tek qytetarët, ndërsa rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, për të akuzuarit të cilët kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e të rekomanduar në Marrëveshjen e pranuar nga gjykata, e njëjta mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tyre korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprën e kryera penale, sinqeritetin e tyre deklarues, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata e pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë, andaj edhe të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit me burgim në kohëzgjatje të cekur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimin mbi konfiskimin gjykata e mori konform nenit 282 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 267 par.5 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë komfor neneve 450, 451 dhe 453 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori komfor nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.05/L-036).

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e paraburgimit në dënimin me burgim është marrë komfor nenit 79 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 363, 364, 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti Special –
PS.nr.57/2022, me datën 23.01.2023

Bashkëpunëtorja profesionale
Luljeta Gashi-Metaj

Kryetari i trupit gjykues
Lutfi SHALA

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.